

AKTI I THEMELIMIT
PËR SHOQËRINË " Let's Drive Albania " shpk

FORMIMI I SHOQËRISË

Sot në Rinas në datën 01.09.2025 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar " Let's Drive Albania " shpk, me vullnetin e lirë të ortakut të vetëm:

Zj. Fludina Shima, shtetase shqiptare, e bija e Dylaverit, e datëlindjes 15.06.1993 lindur në Shkoder dhe banues në Tirane, me adresë Rruga e Kavajes, Nderetesa Nr. 62, Hyrje 1, Njesia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr ID J35615094D.

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria tregtare " Let's Drive Albania " shpk., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Krujes, RINAS, Pasuria Nr. 64/10, Zona Kadastrale 3183, Vol. 6 Faqe 65, Perballe Aeroportit Nderkombetar " Nene Tereza ", 1504, me vendim të ortakut të shoqërisë, mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria tregtare " Let's Drive Albania " shpk, do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100,000 lekë (Njëqind mijë lekë), i cili është tërësisht kapital financiar. Kapitali themeltar përbëhet nga një kuotë 1 (një) me vlerë nominale prej 100,000 lekë (Njëqind mijë lekë).

Kapitali themeltar zotërohet nga:

Fludina Shima, zotërues i 1 (një) kuote apo 100 % të kapitalit të shoqërisë.
Ortaku ka të drejtë të tjetërsojë, të zmadhojë apo të pakësojë kuotat e kapitalit deri në kufinj të përcaktuara nga ligji.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë " Let's Drive Albania " shpk do të jetë:

Veprimtari në fushën e dhenies me qera të mjeteve të transportit si makinave, motoreve, minibus, autobus, kamion, mjete lundruese etj. Veprimtari në fushën e organizimit të guidave turistike, brenda dhe jashtë vendit. Veprimtari në import - eksport, shitjen dhe blerjen e mjeteve motorike. Veprimtari në kryerjen e shërbimeve dhe servisit për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve motorike. Agjensi komisionere për shërbime të dhënies së makinave me qira, ndërmjetësim në shitje-blerje për llogari të palëve të treta dhe shërbime të tjera të ngjashme, etj... të cilat nuk bien në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj duke bërë ndryshimet përkatëse në statut.

Faqja 1 nga 2

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :
 - a- për ndryshime në statut
 - b- emërimin dhe shkarkimin e administratorit
 - c- miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.
 - d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
 - e- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Administratori i përgjithshëm i shoqërisë, është Fludina Shima me afat 5 vjeçar me te drejtë ripërtëritje.

BAZA LIGJORE

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në tre kopje të barazvlefshme të tij.

Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Fludina Shima

